

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje Dekori, viti 2024

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
45451000-3**

VLERA E FONDIT LIMIT: 5.820.000 Lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Ndermarrja Rruga Dures ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

PËRLLOGARITJA E FONDIT LIMIT

Për përlllogaritjen e fondit limit grupi punës u mbështet në VKM 285 date 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 76-mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit

1. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe

b)studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe

c)

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Sqarim

- çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.), nuk pasqyrojnë te dhena objektive per kete procure prokurimi.

çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; nuk janë elemente të vendosur në kontratat e mëparshme dhe detyrimisht nuk prodhojnë çmimi eficient dhe të sakte

U përzgjedh metodologjia e **studimit të tregut**, pika b e VKM së sipërcituar, sepse:

-duke marrë në konsideratë edhe monitorimin dhe çmontimin e elementeve

-dhe marrjen me qira të Pemes së Vitit të Ri e cila do të jetë teresisht e kompletuar me drita dhe figura, sipas fotos në shtojcën përkatëse

-pasi çmimet e atikujve mund të kenë pësuar ndryshime dhe nëpërmjet testimit të tregut arrijmë në një përlllogaritje të përditësuar.

-Grupi punës mori tre oferta për çdo artikull nga një njësi, nga subjekte që zhvillojnë aktivitet në fushën e Dekorimeve, dhe më pas u nxorr mesatarja aritmetike e tyre.

-Ofertat Ekonomike u morën nga subjektet të paisura me certifikatën e regjistrimit të cilën e kishin të ekspozuar sipas rregullave dhe u krye verifikimi i tyre në QKB në mënyrë thjeshtë elektronike mbi statusin e tyre.

-Keto oferta u morën nga Subjektet:

1. Iceberg Communication me NUIS K31518077S me vlerë të ofertes 5.790.000 leke pa TVSH

2. Sezon Dekor me NUIS L21327005P me vlerë të ofertes 5.810.000 leke pa TVSH

3. Tea-AV me NUIS K81317067F me vlerë të ofertes 5.860.000 leke pa TVSH

Dhe kemi $5.790.000 + 5.810.000 + 5.860.000 = 17.460.000$ duke pjesëttuar me 3 (numri ofertave kemi)

$17.460.000 / 3 = 5.820.000$ leke pa TVSH

Ne përfundim fondi limit për këtë procedurë prokurimi është 5.820.000 leke pa TVSH

Afatet e lëvrimit: Për 65 ditë nga nënshkrimi i Kontrates

1. Që korrespondon me dorëzimin, numerimin, verifikimin e tyre pranë AK të elementeve të kërkuar.
2. Montimin e elementeve të dekorit.

**Për pikat 1 dhe 2 afati dorëzimit dhe montimit do të jetë për 15 ditë nga nënshkrimi i kontratës, kjo brenda afatit prej 65 ditë të përcaktuar nga AK si kohezgjatje kontrate.*

3. PERIUDHA FESTIVE JO ME PAK SE 40 DITË, ku kontraktuesi duhet të monitorojë mbarevajtjen në kuptimin teknik të funksionimit të elementeve të dekorit që lidhen me ndriçimin, pra garancia e tyre.
4. Çmontimi i elementeve të dekorit dhe dorëzimi në AK Nd.RRuga sipas rregullave, jo më shumë se 10 ditë.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe DT

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas kërkesave të shtojcës 8 mbi kriteret e përgjithshme të kualifikimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit 55

(Shënim: përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. a.Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron të xhiros vjetore për tre vitet e fundit financiare 2022,2023, Vlera mesatare e xhiros së këtyre dy viteve duhet të jetë jo me pak 40 % i fondit limit të procedurës së prokurimit.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomik arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit nga dy vitet e fundit financiare të kërkuara.

b. Xhirot vjetore të njepasnjeshme nuk duhet të kenë raport negativ midis aktivitetit dhe pasivitetit ndërmjet tyre.

c. Bilancet vjetore te konfirmuara nga zyrat tatimore do te paraqiten perpara marrjes se Njoftim fituesit, nga OE i renditur i pari dhe paraqitjes zyrtare te kerkeses se AK per dorezim dokumentaconi

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar te nevojshme perfshirjen e kriterit te cituar me lart, ne menyre qe t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë pjesemarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme është në përpjesëtim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në ligjin nr.8438 date 28.12.1998 ”Per tatimin mbi te ardhurat”, i ndryshuar, neni 29. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM ”Për rregullat e prokurimit publik”, e cila paashikon se Autoriteti kontraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

Gjithashtu edhe sipas Vendim nr.1084/2023 te KOMISIONIT PROKURIMIT PUBLIK me nr.2504/4prot date 30.10.2023

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë dy viteve të fundit nga data e e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave që janë realizuar gjatë dy viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave që janë realizuar gjatë dy viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Per 65 dite nga dita e nënshkrimit të kontratës

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (*ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b*), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Transporti i mallit do të kryhet nga ana e Kontraktuesit, në çdo rast deri në destinacion, si dhe kontarkuesi duhet të sigurojë të gjithë veglat dhe mjetet e duhura për realizimin e montimit, ndezjes dhe çmontimit.

2.3.3 Montimi dhe çmontimi I elementeve do të kryhet nga Kontraktuesi, sipas të dhënave në seksionin AFATET e LEVRIMIT.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të

prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

2.3.4. Për realizimin e detyres OE duhet të ketë në dispozicion jo më pak se 4 (kater) punonjës të specializuar për periudhën Korrik 2024, Gusht 2024, Shtator 2024 kjo e cila do të vërtetohet me paraqitjen e formularit të sigurimeve shoqërore, standart.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej **minimalisht 4 persona**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Për të përcaktuar numrin e punonjësve dhe të mjeteve/makinerve të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, konkretisht sipas preventivit të punimeve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

